KUSHTET E PËRDORIMIT

Për sistemet softuerike KontX dhe KontXSEF

JU LUTEM LEXONI ME KUJDES. Duke aktivizuar licencën ose duke vazhduar përdorimin e Softuerit, ju konfirmoni se i keni lexuar, kuptuar dhe pranuar këto kushte në emër të biznesit që përfaqësoni.

1. Qëllimi dhe pranimi

1.1. Këto kushte rregullojnë instalimin, licencimin, mirëmbajtjen dhe përdorimin e KontX, KontXSEF dhe moduleve/shërbimeve të ofruara nga I-SOFT SH.P.K. ("I-SOFT").

1.2. Paketa, modulet, numri i licencave, pajisjet, lokacionet, implementimi, trajnimi, periudha dhe shërbimet përcaktohen në Ofertën, pro-faturën ose faturën e pranuar nga Klienti.

1.3. Nëse personi që i pranon këto kushte vepron për një biznes, ai deklaron se është i autorizuar ta lidhë atë biznes me këto kushte.

2. Licenca dhe kohëzgjatja

2.1. I-SOFT i jep Klientit një të drejtë përdorimi joekskluzive, të kufizuar dhe të patransferueshme, vetëm për nevojat e biznesit, pajisjet dhe lokacionet e përcaktuara në Ofertë.

2.2. Marrëdhënia e përdorimit vlen për kohë të pacaktuar, ndërsa periudha e licencës, mirëmbajtjes ose abonimit përcaktohet në dokumentin komercial përkatës. Nuk kërkohet nënshkrimi i një kontrate të re çdo vit.

2.3. Vazhdimi për periudhën pasuese bëhet me pranimin ose pagesën e Ofertës, pro-faturës ose faturës përkatëse.

3. Çmimi dhe pagesa

3.1. Këto kushte nuk përmbajnë çmim fiks. Çmimi, TVSH-ja, kështet, afatet dhe periudha e faturimit përcaktohen në Ofertën ose dokumentin komercial të pranuar.

3.2. Shtimi ose ndryshimi i moduleve, licencave, pajisjeve, lokacioneve apo shërbimeve bëhet me Ofertë të re ose shtesë.

3.3. Në rast mospagese, I-SOFT mund të pezullojë mirëmbajtjen, përditësimet, shërbimet dhe/ose licencën pas njoftimit të Klientit.

4. Shërbimet dhe mirëmbajtja

4.1. I-SOFT instalon dhe mirëmban Softuerin sipas Ofertës dhe korrigjon gabimet e riprodhueshme që janë brenda versionit të mirëmbajtur.

4.2. Mbështetja ofrohet nga e hëna deri të shtunën, 09:00–17:00, përveç festave zyrtare, nëse Oferta nuk përcakton ndryshe.

4.3. I-SOFT nuk përgjigjet për harduerin, sistemin operativ, internetin, energjinë, rrjetin, viruset, printerët, sistemet e ATK-së ose shërbimet e palëve të treta.

4.4. Funksionet ose zhvillimet shtesë nuk janë pjesë e mirëmbajtjes standarde. I-SOFT nuk është i detyruar t'i pranojë; nëse pranohen, fushëveprimi, çmimi dhe afati përcaktohen me Ofertë të veçantë.

5. Detyrimet e Klientit dhe kopjet rezervë

5.1. Klienti siguron pajisjet, rrjetin, sigurinë e infrastrukturës, mbrojtjen e kredencialeve dhe qasjen vetëm për përdoruesit e autorizuar.

5.2. Klienti është përgjegjës për saktësinë dhe ligjshmërinë e të dhënave, artikujve, normave tatimore, çmimeve, operatorëve dhe transaksioneve të regjistruara.

5.3. Klienti duhet të përdorë versionin e autorizuar, të instalojë përditësimet e kërkuara dhe të raportojë menjëherë çdo gabim, incident ose dyshim për cenim të integritetit.

5.4. Kopjet rezervë (BACKUP). Klienti është përgjegjës për krijimin, kontrollimin, ruajtjen dhe testimin periodik të kopjeve rezervë. I-SOFT nuk mban përgjegjësi për humbjen, dëmtimin ose pamundësinë e rikthimit të të dhënave për shkak të mungesës, parregullsisë ose dëmtimit të kopjeve rezervë, përveç nëse menaxhimi i tyre është përfshirë shprehimisht në Ofertën e pranuar.

6. Kushtet e posaçme për KontXSEF-in

6.1. Klienti, si tatimpagues dhe operator i aktivitetit, mban përgjegjësinë e plotë për regjistrimin e shitjeve, lëshimin e kuponëve fiskalë dhe përmbushjen e detyrimeve tatimore.

6.2. Klienti nuk guxon, vetë ose përmes personave të tretë, të ndryshojë, fshijë, anashkalojë ose manipulojë KontXSEF-in, databazën/SQL Server-in, certifikatat, çelësat, ApplicationId, Registry-n, orën e sistemit, numëruesit, kuponët, log-et/hash-et, radhën offline, kopjet rezervë ose komunikimin me ATK-në.

6.3. Ndalohet çdo ndërhyrje që mundëson shitje pa fiskalizim, ndryshim/fshirje transaksionesh, manipulim të numrave ose kronologjisë, bllokim të transmetimit, përdorim të identitetit të një subjekti/POS-i tjetër ose fshehje të gjurmëve.

6.4. Për ndërhyrjet e paautorizuara ose të paligjshme të Klientit, punonjësve, administratorëve, kontraktorëve ose personave me qasje të dhënë nga Klienti, I-SOFT nuk mban përgjegjësi. Përgjegjësia administrative, tatimore, penale, civile dhe financiare i takon Klientit dhe/ose autorit të ndërhyrjes, në masën maksimale të lejuar me ligj.

6.5. Klienti e dëmshpërblen I-SOFT-in për çdo gjobë, tatim, kamatë, dëm, shpenzim ose kërkesë që buron nga ndërhyrja e paautorizuar, përdorimi i paligjshëm, të dhënat e pasakta ose mosfiskalizimi.

6.6. Nëse zbulohet cenim i integritetit ose rrezik ligjor, I-SOFT mund ta pezullojë KontXSEF-in, ta refuzojë transaksionin dhe të kërkojë verifikim teknik. Ky veprim nuk konsiderohet shkelje e detyrimeve të I-SOFT-it.

6.7. Klienti duhet ta njoftojë I-SOFT-in menjëherë për incidentin, të ruajë pajisjen dhe provat dhe të mos bëjë fshirje ose restaurim pa autorizim.

7. Pronësia intelektuale dhe qasja e palëve të treta

7.1. Softueri, kodi burimor, dokumentacioni, dizajni dhe përditësimet mbeten pronë e I-SOFT-it.

7.2. Ndalohet kopjimi, shpërndarja, shitja, nënlicencimi, dekompilimi, inxhinieria e kundërt ose përdorimi në pajisje/subjekte të tjera pa pëlqimin me shkrim të I-SOFT-it.

7.3. Pa pëlqimin paraprak me shkrim të I-SOFT-it, Klienti nuk guxon t'ua prezantojë, shpalosë ose demonstrojë Softuerin palëve të treta dhe as t'u japë qasje fizike ose nga distanca në Softuer, databazë apo dokumentacion.

8. Kufizimi i përgjegjësisë

8.1. I-SOFT nuk përgjigjet për dëme të shkaktuara nga përdorimi i gabuar, të dhëna të pasakta, mungesa e kopjeve rezervë, ndërhyrjet e palëve të treta, viruset, ndërprerjet e energjisë/internetit ose mosinstalimi i përditësimeve.

8.2. Përveç rasteve që nuk mund të kufizohen me ligj, përgjegjësia e përgjithshme e I-SOFT-it kufizohet në shumën e paguar për shërbimin konkret gjatë dymbëdhjetë (12) muajve para ngjarjes.

9. Konfidencialiteti dhe të dhënat

9.1. Palët i ruajnë konfidenciale të dhënat teknike, financiare, kredencialet, certifikatat dhe informacionet e marra gjatë bashkëpunimit.

9.2. Klienti është përgjegjës për bazën ligjore dhe saktësinë e të dhënave personale që përpunon përmes Softuerit.

10. Pezullimi dhe përfundimi

10.1. I-SOFT mund ta pezullojë ose përfundojë licencën në rast të mospagesës, përdorimit të paligjshëm, ndërhyrjes së paautorizuar, cenimit të sigurisë ose shkeljes së pronësisë intelektuale.

10.2. Pas përfundimit ose heqjes së licencës, Klienti duhet ta ndërpresë menjëherë përdorimin, të mos tentojë ta aktivizojë ose përdorë përsëri dhe t'i mundësojë I-SOFT-it çaktivizimin e licencës.

10.3. Përfundimi nuk shuan pagesat e papaguara, konfidencialitetin, pronësinë intelektuale dhe përgjegjësinë për ndërhyrjet ose dëmet e shkaktuara.

11. Ndryshimi i kushteve dhe ligji

11.1. I-SOFT mund t'i përditësojë këto kushte për shkak të ndryshimeve ligjore, teknike, të sigurisë ose të shërbimeve. Për ndryshimet materiale Klienti njoftohet në program ose në mënyrë elektronike dhe, kur kërkohet, duhet t'i pranojë kushtet e reja për të vazhduar përdorimin.

11.2. Për çështjet komerciale mbizotëron Oferta e pranuar; për KontXSEF-in, sigurinë, pronësinë intelektuale dhe përgjegjësinë mbizotërojnë këto kushte.

11.3. Këto kushte rregullohen nga ligjet e Republikës së Kosovës. Mosmarrëveshjet që nuk zgjidhen me marrëveshje trajtohen nga gjykata kompetente në Prishtinë.